



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

Newsletter

TETOR 2023 - 1/2

EVENTE PUBLIKE

RAPORTIM NË KËSHILLIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Në datën 18 tetor 2023, Ministria e Drejtësisë e përfaqësuar nga Znj. Adea Pirdeni, Zëvendësministre e Drejtësisë, raportoi në Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian lidhur me adresimin e rekomandimeve të lëna nga Komisioni Evropian në raportin e vitit 2022 – Kapitulli 23, dhe Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri – Antikorrupsioni.

Znj. Pirdeni u shpreh se Komisioni Evropian ka vlerësuar se zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale Antikorrupsion është në rrugën e duhur. Po ashtu reforma e shërbimeve digjitale, dhe krijimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Denoncimeve mbi Rastet Korruptive (SEMDRK), që ndërvepron me platformën qeveritare e-Albania, platformën e

Bashkëqeverisjes dhe sisteme të tjera në luftën kundër korrupsionit, nxisin hetimin efektiv të veprave penale të lidhura me korrupsionin. Ndër të tjera znj. Pirdeni vlerësoi se Shqipëria ka shenjuar veçanërisht progres në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit, në kuadër të Eurojust. Gjatë takimit u raportua edhe për masat e marra për plotësimin e rekomandimit për Krijimin e Zyrës së Rekuperimit të Aseteve dhe punën impenjative që po bëhet për hartimin e Kodit të ri Penal.



NDËRGJEGJËSIMI



TAKIME ME PËRFAQËSUES TË PLATFORMËS SË PARTNERITETIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN DHE GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Gjatë muajit tetor Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, zhvilloi një tjetër takim me përfaqësues të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitujt 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe 24 “Drejtësi, liri dhe siguri” kushtuar konsultimit të draft udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, bota akademike dhe ekspertë të fushës të cilët pasi ishin njohur me draft udhërrëfyesin diskutuan në mënyrë aktive duke ofruar sugjerime dhe komente me qëllim përmirësimin e këtij dokumenti.

Gjithashtu gjatë muajit tetor, Drejtoria e Integritimit dhe Negociatave organizoi një takim Grupi Ndërinstitucional Pune për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterin Politik me fokus hartimin e Planit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian 2024 - 2030 dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026. Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian ka si synim të adresojë përmes masave politike dhe ligjore, institucionale, zbatuese dhe investimeve përkatëse, linjëzimin e të gjithë kuadrit rregullator shqiptar me acquis të BE-së si dhe zbatimin efektiv të tij.

WORKSHOPE & TRAJNIME

TRAJNIM I ZHVILLUAR NË KUADËR TË POPULLIMIT TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Shërbimet e Komisionit Evropian në kuadër të mbështetjes së kapaciteteve të vendeve candidate dhe atyre candidate potenciale, për të mbledhur dhe raportuar në mënyrë konsistente dhe të plotë, të dhënat në lidhje me historikun e ndjekjeve dhe dënimeve penale, kanë krijuar një platformë të re elektronike për mbledhjen, raportimin dhe përpunimin e informacionit të raportuar nga shtetet në kuadrin e veprave penale të përcaktuara. Në 17 tetor 2023 u mbajt trajnimi i rradhës për të gjitha vendet candidate ku, nga pala shqiptare morën pjesë përfaqësues nga gjykatat dhe prokuroritë e vendit, ILDKPKI, AAPSK, MB dhe MD.

Gjatë trajnimit përdoruesit e platformës, të akredituar tashmë, u informuan rreth specifikave që paraqet kjo platformë, ofruan asistencë për sa i përket disa çështjeve teknike për hedhjen e të dhënave si dhe diskutuan me të gjithë përdoruesit për sa i përket përmirësimeve të mundshme që mund të kryhen në këtë platformë e cila përmbush standardet më të larta të sigurisë për sa i përket të dhënave të hedhura.



TRAJNIM NË BELGJIKË ME KOLEGJIN E EVROPËS

Në datat 11-12 tetor 2023, Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) në bashkëpunim me Kolegjin e Evropës organizoi trajnimin ekzekutiv për integrimin në BE, në Bruges, Belgjikë. Pjesë e trajnimit ishin edhe nëpunës të Drejtorisë së Integritimit dhe Negociatave.

Trajnimi kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe shërbeu edhe si një mundësi për të rritur dhe promovuar bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive në fushën e integritimit evropian veçanërisht në çështje që lidhen

me sfidat aktuale për BE-në dhe ndikimi i këtyre sfidave në porcesin e zgjerimit, marrëdhëniet e jashtme të BE-së, financat publike dhe politikat buxhetore të BE-së, komunikimin me BE-në, si dhe me transformimin digjital të BE-së. Gjatë zhvillimit të këtij trajnimi u diskutua me ish-Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë dhe Rektoren e Kolegjit të Evropës Znj. Federica Mogherini për rëndësinë e fuqizimit të kapaciteteve institucionale për procesin e integritimit evropian

TAKIMI NE SHKUP ‘LET THE JUSTICE RULE THE REGION’

Përfaqësues nga Drejtoria e Integritimit dhe Negociatave pranë Ministrisë së Drejtësisë, më 19 tetor, morën pjesë në Konferencën Rajonale me fokus grupkapitullin e parë- Themelorët, në kuadër të nismës së përbashkët të Lëvizjeve Europiane në Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut -"Let the Justice Rule the Region", me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përfshirjen e shoqërisë civile në proces. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga tre vendet e rajonit u diskutua gjerësisht rreth Shtetit të së Drejtës dhe sundimit të ligjit, progresit të bërë dhe sfidave të përbashkëta. Takimi shërbeu për ndarjen e eksperiencës dhe praktikave më të mira mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe nxitjen e bashkëpunimit të aktorëve shtetërorë me shoqërinë civile në rrugëtimin e përbashkët për anëtarësim në Bashkimin Evropian



<https://web.facebook.com/drejtesia.gov.al>



https://www.instagram.com/ministria_drejtesia/

<https://www.drejtesia.gov.al>



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

Newsletter

TETOR 2023 - 2/2

WORKSHOPE & TRAJNIME



TAKIM NDËRINSTITUCIONAL MBI PËRGATITJEN E PLANEVE TË PËRBASHKËTA TË PUNËS NË KUADËR TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022-2026

Në datë 3 tetor 2023, përfaqësues nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, morën pjesë në takim e organizuar nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në kuadër të zbatimit të planeve të përbashkëta të punës ndërmjet QPKMR dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në këtë takim u diskutuan masat dhe aktivitetet ku QPKMR dhe DPB janë institucione përgjegjëse në zbatim të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, si dhe realizimi i një plani pune të përbashkët ndërmjet QPKMR dhe DPB për të rinjtë e grup moshës 18-21 vjeç që janë në prag lirim nga IEVP-të.

TAKIM NDËRMJET PROJEKTTIT JUSTAL DHE DREJTORISË SË POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË NË KUADËR TË MIRËMENAXHIMIT TË PROCESEVE TË PUNËS

Në datat 18 – 19 tetor 2023, stafi i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, mori pjesë në workshopin e zhvilluar nga projekti JustAL në kuadër të mirëmenaxhimit të procesit të punës mbi dokumentat strategjik të Ministrisë së Drejtësisë. Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi i kapaciteteve të stafit të drejtorisë mbi elementët e administrimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të strategjive të cilat hartohen dhe monitorohen nga Ministra e Drejtësisë. Sugjerimet e projektit JustAL mbi mjetet/metodat e shpjguara përgjatë këtyre ditëve, si dhe koordinimi ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë dhe institucioneve raportuese, shërbyen për të zhvilluar situata konkrete mbi punën e drejtorisë.



TAKIM I PËRBASHKËT PUNE LIDHUR ME DREJTËSINË PENALE TË TË MITURVE NË SHQIPËRI

Në datën 02 tetor 2023 në Rezidencën e Ambasadës së Francës, u zhvillua takimi për ndarjen e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit hartuar me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë Franceze në kuadër të “Drejtësisë së të miturve në Shqipëri”. Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, mori pjesë në këtë takim në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e drejtësisë, ku mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të institucionit tonë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: “Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale”.



RISI

PREZANTIM PRANË KËSHILLIT KONSULTATIV “QEVERI QENDRORE – VETËQEVERISJE VENDORE”, TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024 – 2030

Më datë 11, tetor 2023, Zëvendësministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta mori pjesë në Këshillin Konsultativ “Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore”, të udhëhequr nga z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor. Gjatë fjalës së tij, z. Karameta bëri një pasqyrim të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030, ku ndër pikat që ai preku ishte angazhimi dhe rëndësia e përfshirjes së vetëqeverisjes vendore në këtë Strategji.

Ministria e Drejtësisë në rolin e institucionit përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave strategjike në fushën e drejtësisë ka ndjekur procesin e hartimit Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030, Planin e Veprimeve dhe Pasaportën e Treguesve, të cilat janë ideuar në përputhje të plotë me strategjinë e BE-së “Për të drejtën e viktimave 2020 – 2025”.




<https://web.facebook.com/drejtesia.gov.al>



https://www.instagram.com/ministria_drejttese/

<https://www.drejtesia.gov.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË